



REPUBLIKA E MAQEDONIS SË VERIUT
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 dhe nenit 23 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 12/2019) në nenin 36 paragrafi 1 dhe nenit 40 dhe 41 të Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, KSHPK duke vepruar në bazë të denoncimit nga parashtrues i njohur, në vazhdimin e seancës së 51-të, të mbajtur më datë 01.09.2021 morri,

VENDIM

Denoncimi për korrupsion nr. 12-1685 / 1, datë 26.04.2021 nga parashtrues i njohur -----
-----, REFUZOHET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit nuk ka juridiksion - nuk ka pohime ose indikacione të qarta për veprime të paligjshme ose të palejueshme të personave zyrtarë në ushtrimin e autoritetit publik dhe detyrës zyrtare në rastin Nr. 12-1685 nga 2021 i formuar në bazë të denoncimit me nr. 12-1685/1 nga 26.04.2021.

Lënda me numër 12-1685 e vitit 2021 të mbyllet dhe të arkivohet.

Vendimi i Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, me arsyetim - në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Kopje nga vendimi të dorëzohet deri te parashtruesi i denoncimit.

Arsyetim

Lënda me numër 12-1685 nga 2021 u formua në bazë të denoncimit nr. 12-1685/1, datë 26.04.2021, nga parashtrues i njohur -----, dhe e njëjta është dorëzuar përmes një aplikacioni në internet për denoncimin e korrupsionit.

Në denoncim tregohet për parregullsi në NP ----- nga -----, në pjesën e punësimit të drejtorit ----- dhe zv. drejtorit -----, si dhe parregullsi në fushën e prokurimit dhe disponimit të fondeve për përdorimin e tyre nga, siç thuhet në denoncim, persona private për interesa personale dhe interesa të tjerë, por pa dëshmi ose udhëzime specifike se si mund të sigurohet.

Prandaj, pas shqyrtimit të denoncimit, KSHPK iu drejtua parashtruesit përmes e-mail në mënyrë që të siguronte informacion shtesë specifik në lidhje me indikacionet në aplikim.

Parashtruesi ----- paraqiti dy herë një shpjegim në të cilin u vendosën informacione të palidhura në lidhje me dyshimet pas punës dhe veprimeve në NK -----, -----, pa theksuar në mënyrë të veçantë shkeljen e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit ose ligjeve të tjera.

Bazuar në të gjitha rrethanat dhe të dhënat e përfshira në denoncimin e lëndës, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, nga aspekti i kompetencave të Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit në denoncimin e lëndës përcakttoi se nuk ka indikacione të veçanta për elemente konkrete korruptive nga ana e parashtruesit të denoncimit.

Për arsye, siç u tha më lart, Komisioni Shtetëror vlerësoi se denoncimi nuk përmban elemente për veprime kompetente të Komisionit Shtetëror në përputhje me nenin 17 të Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit.

Duke pasur parasysh të theksuarën e mësipërme, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit vendosi si në dispozitën e këtij vendimi.

KOMISIONI SHTETËROR
PËR PARANDALIMIN E
KORRUPSIONIT
Kryetar,
Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri te:
Arkivi
Parashtruesi

Përgatiti: M.r K.Z, Këshilltar
Miratoi: SPD, Anëtar i KSHPK-së

